

---

**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

**Drejtuar:** Operatorit Ekonomik “**MEKTRIN MOTORS**” shpk, me NUIS: **K51408501P**, me adresë: “*DURRES AUTOSTRADA KM.6 XHAFZ.*”.

**- OE/BOE me nënkontraktor****PO** ☐ **JO** ☒Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:****PO** ☐ **JO** ☒Nëse po, të jepen dhënat: \_\_\_\_\_

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

**Tipi i Kontratës:** Mallra**Lloji i Procedurës së prokurimit:** E hapur, mbi kufirin e lartë monetar.**Referenca e Lotit:** REF-72609-12-17-2025.

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Blerje automjete te reja, tip autoburgje të blinduara me kategori të sigursë (blindimit) “BR6”, për sistemin e Burgjeve për vitin 2025”, me afat zbatimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.

**Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit:** 06.02.2026.

**Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit:** Buletini Nr. 13 datë 9 Shkurt 2026.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

|                                               |                        |
|-----------------------------------------------|------------------------|
| <b>1. BOE “Timak Special Vehicles” SH.P.K</b> | <b>M01706003U</b>      |
| <b>&amp;</b>                                  |                        |
| <b>“TIMAK” SH.P.K</b>                         | <b>L62030020B</b>      |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i>               | <i>Numri i NIPT-it</i> |

Vlera: **57,467,000** (pesëdhjetë e shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

|                                      |                        |
|--------------------------------------|------------------------|
| <b>2. OE “MEKTRIN MOTORS” SH.P.K</b> | <b>K51408501P</b>      |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i>      | <i>Numri i NIPT-it</i> |

Vlera: **64,010,000** (gjashtëdhjetë e katër milion e dhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

|                                             |                        |
|---------------------------------------------|------------------------|
| <b>3. OE “ALBANIA MOTOR COMPANY” SH.P.K</b> | <b>K41829010I</b>      |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i>             | <i>Numri i NIPT-it</i> |

Vlera: **64,990,000** (gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

|                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| <b>4. OE “VIBTIS” SH.P.K</b>    | <b>L02103503S</b>      |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>Numri i NIPT-it</i> |

Vlera: **66,433,333** (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

|                                               |                        |
|-----------------------------------------------|------------------------|
| <b>1. BOE “Timak Special Vehicles” SH.P.K</b> | <b>M01706003U</b>      |
| <b>&amp;</b>                                  |                        |
| <b>“TIMAK” SH.P.K</b>                         | <b>L62030020B</b>      |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i>               | <i>Numri i NIPT-it</i> |

Vlera: 57,467,000 (pesëdhjetë e shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Me dokumentacionin e paraqitur me dokumentacionin e paraqitur rezulton se nuk përmbush kërkesën **2.3.1** të kapacitetit teknik për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit ku thuhet:

*“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

**a.** *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

**b.** *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”*

Konkretisht referuar kontrates se bashkepunimit te ngarkuar ne SPE konstatohet qe pjesmarrja e anetareve te BOE eshte **Timak Special Vehicles, Nipt M01706003U – 60% (gjashtëdhjetë për qind)** dhe **Timak Shpk, Nipt L62030020B – 40% (dyzet për qind)** cka e perkthyer ne vlere qe secili prej operatoreve pjesmarres ne kete BOE duhet te plotesoje eshte **Timak Special Vehicles, Nipt M01706003U** ne vleren **15,943,999.92** leke pa tvsh dhe **Timak Shpk, Nipt L62030020B** ne vleren **10,629,333.28** leke pa tvsh.

Ne permbushje te kriterit te mesiperm BOE ka paraqitur ne SPE dokumentacionin si meposhte :

- Marreveshje Kontraktuale Nr ITBM-C-23-009 Date 18 GUSHT 2023, nenshkruar ndermjet kontraktorit ITBM Group Ltd dhe **Timac Shpk, Nipt M01706003U**
- Fature Tatimore Nr 48 Date 17.04.2024 leshuar per ROYAL SECURITY SH.P.K. nga **TIMAC SHPK, Nipt M01706003U**
- Marreveshje Bashkepunimi nenshkruar ndermjet Nato/KFOR DHE “**Timac Special Vehicles**” **Shpk, Nipt M01706003U**
- Kontrate Shitje ndermjet “IKG Munchen and Oberbayern” dhe **Timac Shpk, Nipt M01706003U**
- Kontrate bashkepunimi ndermjet **Timac Shpk, Nipt M01706003U** dhe “Autovision”sh.a

Pas shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur per plotesimin e kriterit 2.3.1 sipas perqindjes nga anetari i BOE **Timak Special Vehicles, Nipt M01706003U** e cila duhet te jete ne vleren prej 15,943,999.92 leke pa tvsh, gjykohet qe dokumentacioni si vijon “*Marreveshje Kontraktuale Nr ITBM-C-23-009 Date 18 GUSHT 2023, nenshkruar ndermjet kontraktorit ITBM Group Ltd dhe Timac Shpk, Nipt M01706003U*”, “*Kontrate Shitje ndermjet “IKG Munchen and Oberbayern” dhe Timac Shpk, Nipt M01706003U*”, “*Kontrate bashkepunimi ndermjet Timac Shpk, Nipt M01706003U dhe “Autovision”sh.a*” nuk do te konsiderohen objekt shqyrtimi pasi nisur nga fakti qe keto kontrata, marreveshje e siperpermendura jane nenshkruar me subjekte private, duhej qe këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, të vërtetoheshin me dokumentacionin perkates “*faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara*”, referuar kriterit 2.3.1, pika b dhe gjithashtu “*Marreveshje Bashkepunimi nenshkruar ndermjet Nato/KFOR DHE “Timac Special Vehicles”Shpk, Nipt M01706003U*” nuk do te konsiderohet objekt shqyrtimi pasi nisur nga fakti qe kjo kontrate eshte nenshkruar me nje ent nderkombetar si NATO, duhej qe ky furnizim i mëparshme, i ngjashem, të vërtetohej me dokumentacionin perkates “*vertetimi i realizimit për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara*”, referuar kriterit 2.3.1, pika a. Ne perfundim te analizimit te dokumentacionit provues te paraqitur nga anetari i BOE **Timak Special Vehicles, Nipt M01706003U** dokumentacioni i vetem i vlefshem ne permbushje te kriterit 2.3.1 do te merret “*Fature Tatimore Nr 48 Date 17.04.2024 leshuar per ROYAL SECURITY SH.P.K nga TIMAC SHPK, Nipt M01706003U*” me objekt te sajine “*Konvertimi I mjetit ne makine transporti parash te blinduar BR4*” me vlere 17,400 euro, e konveruar ne monedhen lek vlera eshte ne perafersi te saj 1,740,000 leke pa tvsh. Nisur nga analiza e siperpermendur vleresojme qe anetari i BOE **Timak**

**Special Vehicles, Nipt M01706003U** nuk ka arritur te permbush kriterin 2.3.1 ne baze te perqindjes se pjesmarrjes ne kete BOE pasi vlere e furnizimeve te ngjashme te paraqitura eshte 1,740,000 leke pa tvsh, ndersa vlere qe duhej te paraqiste anetari i BOE **Timak Special Vehicles, Nipt M01706003U** ne baze te perqindjes se pjesmarrjes ne BOE duhet te ishte 15,943,999.92 leke pa tvsh.

Ndersa per sa i perket anetarit tjeter te BOE **Timak Shpk, Nipt L62030020B**, i cili referuar marreveshjes se bashkepunimit te paraqitur ne SPE eshte pjesmarres ne kete jonventure ne masen 40% (dyzet per qind) dhe deshmite per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, duhej te paraqiteshin ne SPE sipas kerkesave ne piken 2.3.1 ne vleren **10,629,333.28** leke pa tvsh, konstatohet qe nuk jane paraqitur ne SPE deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates te vertetuara me dokumentacionin e parashikuar ne pikat a dhe b te kriterit 2.3.1.

Në këto kushte, referuar nenit 88 të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, pika 3 ku parashikohet që:  
*“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, bashkimi i Operatoreve **Timak Special Vehicles, Nipt M01706003U dhe Timak Shpk, Nipt L62030020B, skualifikohet***

**2. OE “ALBANIA MOTOR COMPANY” SH.P.K K41829010I**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera: 64,990,000 (gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit per arsyet si meposhte:

- Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.3.3 te Kapacitetit Teknik pasi per servisin qe disponon sipas kontrates se qerese Nr Rep 1163, Date 27.05.2025 te ngarkuar ne SPE operatori ekonomik “Albanian Motor Company”, Nipt K41829010I nuk ka paraqitur Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktūrës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licencat. Gjithashtu OE ne permbushje te ketij kriteri ka paraqitur si mbeshtetes subjektin “Nova Auto Solution” shpk, NIPT K67120001D per licencen VII.3.B.1, por kjo bie ne kundërshtim me piken 2.16 te DST ku specifikohet qe **“Ndalohe**

***mbeshtetja per piken 2.3 kapaciteti Teknik i KVK pasi këto kritere lidhen ngushtë me aftësinë e ofertuesve për të realizuar kontratën***”.

- Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur çertifikatë të vlefshme, të lëshuar nga një entitet vendas ose europian dhe ku të citohet materiali i testuar dhe kalibrat e plumbave.
- Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.3.7 te Kapacitetit Teknik pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur test raport nga kompania që bën konvertimit e mjetit, për testimin e materialit të celikut të blinduar me min 6.5 mm.
- Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.3.8 te Kapacitetit Teknik pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur raport tesim (nga subjekti që bën konvertimin e mjetit) për testimin e xhamit në përputhje me **standardin EN 1063:1999** (ose ekuivalent).

**3. OE “VIBTIS” SH.P.K**

**L02103503S**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera: 66,433,333 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit per arsyet si mëposhte:

- Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.1.b pasi afati i vlefshmërisë së formularit të sigurimit të ofertës te paraqitur nga operatori ekonomik **“Vibtis” Shpk, Nipt L02103503S**, nuk është sipas përcaktimeve në Seksionin 3 të dokumenteve të tenderit pika 1 “Sigurimi i ofertes”. Ne rastin e sigurimit te ofertes se paraqitur nga **Vibtis” Shpk, Nipt L02103503S** kompania e sigurimit “Intersig Vienna Insurance Group” SHA ka percaktuar qarte afatin e fillimit 16.01.2026 dhe te mbarimit 15.06.2026 te sigurimit te ofertes me numer BND0024194 dhe per rrjedhoje nuk mbulon periudhen 150 ditore nga data e hapjes se ofertave date e cila eshte 19.01.2026.  
Qendrim i mbajtur dhe nga ana e Komisionit te Prokurimit Publik Nr 104/2026, date 20.01.2026.
- Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.3.2 pasi referuar CoC te ngarkuar ne SPE ne permbushje te pikes 2.3.9 konstatohet qe OE ka ofruar automjete Iveco nderkohe nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar per kete mjet te ofruar, per me teper autorizimi i prodhuesit i leshuar nga kompania **”Technology and security Developments SL”** e cila do te pershtase automjetin e ofertuar Iveco duke krijuar produktin final sipas specifikimeve teknike por kjo kompani thjesht do pershtase makinën autoburg si

produkt final dhe ne autorizimin e leshuar per OE nuk vertetohet se eshte prodhues /ose distributori i autorizuar i automjetit Iveco i ofruar.

- Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.3.5 pasi referuar CoC te ngarkuar ne SPE ne permbushje te pikes 2.3.9 konstatohet qe OE ka ofruar automjete Iveco nderkohe qe ne permbushje te kriterit 2.3.5 ka paraqitur nje oferte teknike te leshuar nga **”Technology and security Developments SL”**, oferte teknike e cila nuk eshte katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar sepse sic e thame me lart kompania **”Technology and security Developments SL”** nuk eshte prodhuese ose distributor i autorizuar per automjetin Iveco te ofruar nga OE referuar dokumentacionit te ngarkuar ne SPE.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“MEKTRIN MOTORS”** shpk, me adresë: **“DURRES AUTOSTRADA KM.6 XHAFFZ”**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **64,010,000** (gjashtëdhjetë e katër milion e dhjetë mijë) **lekë pa TVSH** është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve**, me adresë: *Rruga “Zef Serembe”, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit që do t’iu njoftohet nga autoriteti kontraktor përfitues.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

**PO**     ☐                      **JO X**

Nëse Po ( Nr.\_\_\_\_ Datë\_\_\_\_ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**